



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

Numri i lëndës: 2022:042937

Datë: 23.01.2026

Numri i dokumentit: 08356996

K.DH.SH.II.nr.1593/25

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fisnik NULI, kryetar i kolegjit, Alajdin TËRSHNJAKU dhe Krenar BERISHA, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Kosovo Electricity Supply Company J.S.C. Sh.A., (KESCO), me seli në Prishtinë, Bulevardi “Bill Klinton”, nr.5, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji, me seli në Prishtinë, rr. “Bekim Fehmiu”, me bazë juridike anulim i vendimit me numër V\_1476\_2022 të datës 14.01.2022, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1126/22, të datës 12.06.2025, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 15.01.2026, merr këtë

**A K T G J Y K I M**

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit Kosovo Electricity Supply Company J.S.C. Sh.A. (KESCO), me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës - Departamenti për Çështje Administrative KA.nr.1126/22 i datës 12.06.2025, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për çështje Administrative, me aktgjykimin e ankimuar KA.nr.1126/22, të datës 12.06.2025, e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit Kosovo Electricity Supply Company J.S.C. Sh.A., (KESCO), me të cilën ka kërkuar anulimin e pikës II të dispozitivit të vendimit në tabelën në vijim të kësaj pike, lidhur me borxhin e keq në % e cekura për vitin 2022, 2023 dhe 2024 të Vendimit me numër V\_1476\_2022 të datës 14.01.2022, të nxjerrë nga i padituri Zyra e Rregullatorit për Energji.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të: shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar, ndërsa aktgjykimi ankimuar të ndryshohet duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që të anulohet pika II të dispozitivit e Vendimit V\_1476\_2022 të datës 14.01.2022 të ZRRE-së, ose aktgjykimi i ankimuar të priset dhe kjo çështje të kthehet në rigjykim.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur e paditura, me propozim që ankesa e paditësit të refuzohet si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, e shqyrtoi ankesën e paditësit, aktgjykimin e ankimuar, përgjigjen në ankesë, si dhe shkresat e tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të tyre në vështrim të nenit 89 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA-së), dhe neni 194 të LPK-së, ligj i zbatueshëm si në vështrim të nenit 2 par.3 të LKA-së, gjen se:

- Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me e paditura Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me vendimin V\_1476\_2022 të datës 14.01.2022, nën pikën I të dispozitivit ka aprovuar Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU) për periudhën tarifore 2022- 2024. Ndërsa nën pikën II të dispozitivit Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU), i ka paraqitur në tabelë, ku sa i përket borxhit të keq në % për vitin 2022 është 2.4, për vitin 2023 është 2.2 ndërsa për vitin 2024 është 2.0.

I pakënaqur me vendimin e lartcekur të të paditurës, paditësi me datën 03.03.2022 me padi ka inicuar konfliktin administrativ në Gjykatën e shkallës së parë e cila në këtë çështje ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të seancës së shqyrtimit kryesor ka marr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar.

Në arsyet e dhëna në aktgjykimin e atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se: “Pala e paditur ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore procedurale dhe materiale kur me Vendimin V\_1476\_2022, datës 14.01.2022, në kuadër të shqyrtimit të Tarifave të energjisë Elektrike ka aprovuar Vlera Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU) për periudhën tarifore 2022-2024. Tutje, ka theksuar se i padituri në përputhje me nenin 15 të Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë ka ushtruar përgjegjësitë dhe autoritetin e tij, në të cilin është përcaktuar se: *“Për përmbushjen e detyrave, Rregullatori ka autoritetin dhe përgjegjësitë në vijim: 1.1. t’i miratojë në afatin ligjor metodologjitë të cilat shfrytëzohen për t’i llogaritur apo për t’i përcaktuar kushtet dhe kriteret për:... 1.1.5. vendosje të detyrimit të shërbimit publik në licencën e cilitdo furnizues, duke e obliguar atë furnizues që t’i furnizojë konsumatorët familjarë dhe konsumatorët e vegjël me energji elektrike të një cilësie të caktuar në kushte të rregulluara.”* Pra, lidhur me këtë, gjykata ka vlerësuar se i padituri ka vepruar drejtë ku me vendimin e atakuar ka aprovuar Vlerat Hyrëse dhe Shpenzimet Operative (OPEX) për Furnizuesin me Shërbim Universal të Energjisë Elektrike (FSHU) për periudhën tarifore 2022- 2024, sepse me nenin 37 par.6 të Ligjit Nr. 05/L085 Për Energjinë Elektrike përcaktohet se: *“Rregullatori siguron që çmimet e energjisë elektrike që i nënshtrohen rregullimit, për qëllim të sigurimit të shërbimit universal, të reflektojnë koston. Reflektimi i koston duhet të mbulojë koston reale të furnizimit me energji elektrike, duke përfshirë koston e prodhimit, koston e balancimit, koston margjinale afatshkurtër, duke reflektuar portofolin e plotë të prodhimit, investimet e domosdoshme shkallën e duhur të kthimit, koston e importeve, koston e shërbimeve të furnizimit, si dhe borxhet e këqija”,* Andaj, nga konstatimet e paraqitura më lartë, gjykata ka vlerësuar se i padituri me rastin e nxjerrjes së Vendimit V\_1476\_2022 të datës 14.01.2022, ka zbatuar drejtë dispozitat ligjore procedurale dhe materiale, dhe për këtë arsye e ka refuzuar në tërësi si të pa bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Kolegji i Gjykatës Komerciale të Kosovës- Dhomat e Shkallës së Dytë, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, duke shqyrtuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë në bazë të ankesës së paditësit dhe sipas detyrës zyrtare të njëjtin e konfirmon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar në prova dhe ligj, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të LKA-së dhe LPK-së, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i vlerëson sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji, vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar administrativ në bazë të padisë, përgjigjes në padi, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor si dhe shkresave të tjera të lëndës në vështrim të nenit 8 të LPK-së dhe nenit 89 të LKA, dhe drejtë e ka vendosur çështjen me refuzimin e kërkesëpadisë së paditësit.

Kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar pretendimet ankimore të paditësit ankimore se aktgjykimi i ankimuar përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që dispozitivi i tij është kontradiktor me arsyet e aktgjykimit dhe në të nuk janë treguar fare arsyet për faktet vendimtare, ndërsa ato që janë treguar janë të paqarta dhe në kundërshtim me provat e bashkangjitura, mirëpo të njëjtat i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme. Sepse sipas vlerësimit të këtij kolegji, Dhoma e Shkallës së Parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit Dhoma e Shkallës së Parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LPK-së dhe LKA-së. Po ashtu, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe nuk është në kundërshtim me vetveten ose me arsyet e tij, respektivisht në mes të arsyeve të aktgjykimit dhe provave të administruara, kjo për faktin se Dhoma e Shkallës së Parë ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta për faktet vendimtare, duke sqaruar se cilat fakte i ka konsideruar të provuara dhe mbi bazën e cilave prova ka vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Tutje, kolegji i kësaj gjykate ka vlerësuar edhe pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë kurrfarë vlerësimi të pretendimeve se vendimi i të paditurës për përcaktimin e vlerave hyrëse për borxhet e këqija 2.4%, 2.2% dhe 2.0 % për vitin 2022-2024, e ka vënë paditësin në një pozitë të vështirë financiare, pasi që këto vlera nuk reflektojnë koston, mirëpo të njëjtat i vlerëson si të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga Dhomat e Shkallës së Parë. Sepse me dispozitën ligjore nga neni 37 par. 6 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Zyrës së Rregullatorit të Energjisë i është dhënë kompetencë e plotë ligjore që të siguron se çmimet e energjisë elektrike që i nënshtrohen rregullimit, për qëllim të shërbimit universal të reflektojnë koston, i cili reflektim duhet të mbulojë koston reale të furnizimit me energji elektrike duke përfshirë koston e prodhimit, koston e balancimit, koston margjinale afatshkurtër, duke reflektuar portofolin e plotë të prodhimit, investimet e domosdoshme shkallën e duhur të kthimit, koston e importeve, koston e shërbimeve të furnizimit, si dhe borxhet e këqija. Tutje, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se paditësi përkundër

pretendimeve të tij, nuk ka ofruar prova konkrete dhe bindëse që do të dëshmonin se këto vlera janë vendosur në kundërshtim me dispozitën ligjore të lartcekur, apo nëse ato janë përcaktuar në mënyrë arbitrare dhe nuk janë në kompetencë të të paditurës. Andaj, për arsyet e lartcekura kolegji i kësaj gjykate vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë.

Përfundimisht, Dhoma e Shkallës së Dytë i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Nga të lartë cekurat e në vështrim të nenit 89, 90 dhe 95, të LKA, dhe neni 200 i LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS  
Dhoma e Shkallës së Dytë  
K.DH.SH.II.nr.1593/25, me datë 15.01.2026



Kryetar i Kolegjit, Gjyqtari  
Fisnik NULI